

STRATEGJIA

3 VJEÇARE E ZHVILLIMIT TË SHËRBIMIT SPITALOR

2023

QSU | SPITALI QENDROR

QENDRA SPITALORE
UNIVERSITARE "NËNË
TEREZA"

\ PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT

Titulli	Strategjia 3-vjeçare e zhvillimit të shërbimit spitalor
Koha e rishikimit	Sipas nevojës
E drejta e autorit	Ky është një publikim i QSUT. Ndalohet kopjimi i pjesëve të këtij materiali pa lejen e QSUT

Historiku i rishikimeve

Rishikimi nr.	Data e rishikimit	Përmbledhje e ndryshimeve

* Nëse nuk kërkohen ndryshime, shkruani komentet "të rishikuara - nuk kërkohen ndryshime"

** Nëse kërkohen ndryshime të natyrës së rëndësishme, ju lutemi dorëzoni një kopje të rishikuar me ndryshime të theksuara në Drejtori për miratim

*** Nëse nuk ka ndryshim në dokument, numri i rishikimit dhe data e hyrjes në fuqi do të mbeten të njëjta

Emri	Pozicioni	Nënshkrimi	Data
Përgatitur nga			
Enisa Rexhepi	Drejtor i Performancës Spitalore		1.6.2023
Miratuar nga			
Prof. Asc. Dr. Albana Fico	Drejtor i Përgjithshëm		2.6.2023

\ PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1	HYRJE	5
1.1	HYRJE.....	5
1.2	KUADRI LIGJOR.....	5
1.3	MISIONI	5
1.4	VIZIONI	6
1.5	VLERAT DHE PARIMET	6
1.6	QSU "NËNË TEREZA" NË SHIFRA	6
1.6.1	AKTIVITETI SPITALOR.....	6
1.6.2	NDËRHYRJET KIRURGJIKALE	7
1.6.3	BURIMET NJERËZORE	9
1.7	BUXHETI	10
1.8	PROJEKSIONI I POPULLSISË SË CILËS I OFROHET KUJDES	10
2	STRATEGJIA.....	13
2.1	QELLIMI I STRATEGJISË.....	13
2.2	OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	13
2.2.1	MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS SPITALORE	13
2.2.2	PËRMIRËSIMI I SISTEMIT INFORMATIK SPITALOR.....	16
2.2.3	IMPLEMENTIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË, BAZUAR NË STANDARTET ISO 9001:2015	18
2.2.4	FUQIZIMI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT	19
2.2.5	KRIJIMI I NJË PLATFORME INTERAKTIVE PËR PACIENTË "PACIENTËT SI PARTNERË"	20

\ SHKURTIME

MSHMS	MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
QSUT	QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE NËNË TEREZA
OBSH	ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETËSISË
PSO	PROCEDURA STANDARDE E OPERIMIT
SISP	SISTEMI I INFORMATIZIMIT TË SHËNDETIT PUBLIK
PBA	PROJEKTBUXHETI AFATMEËM
ASCK	AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SHOQËROR
FSDKSH	FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR



"Qëllimi i punës sonë të përditshme është që çdo pacienti dhe familjari t'i ofrohet shërbim profesional dhe kujdes cilësor. Ne synojmë të zhvillojmë kulturën e shërbimit dhe respektit ndaj pacientit në çdo shërbim. Ndaj, ju ftoj të gjithëve, si partnerë, të bëheni pjesë aktive e zhvillimit të mëtejshëm të kulturës për ofrimin e shërbimit cilësor. Ju ftoj gjithashtu për ta parë drejtimin spitalor, jo vetëm si një pozicion, por si një përgjegjësi për krijimin e një atmosfere që na frymëzon për të vendosur gjithmonë pacientin të parin. Rezultatet pozitive të punës, në sajë të përkushtimit maksimal të stafit të mjekëve, infermierëve dhe punonjësve tanë, mbështeten në vizionin: "Kur qytetarët mendojnë për kujdes shëndetësor profesional, ata mendojnë për QSUT". Është një privilegj të jesh pjesë e këtij organizmi, i cili është një burim krenarie për komunitetin. Është një privilegj të jesh pjesë e kësaj strukture, e cila kujdeset për jetën e mijëra pacientëve çdo ditë. Ne shpresojmë me punën tonë të përmbushim pritshmëritë e çdo qytetari"

Drejtor i Përgjithshëm

Prof. Asc. Dr. Albana Fico

1 HYRJE

1.1 HYRJE

Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza është ofruesi më i madh i shërbimeve shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, ku realizohen funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për formimin universitar të studentëve të Universitetit të Mjekësisë.

Qendra Spitalore Universitare ka një staf me përvojë, të kualifikuar, i cili synon ofrimin e shërbimeve cilësore të diagnostikimit dhe trajtimit.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore, bazuar në referencat më të mira ndërkombëtare, investimet e reja në pajisje mjekësore bashkëkohore dhe në infrastrukturën spitalore e bëjnë QSUT, një lider në sektorin shëndetësor kombëtar.

1.2 KUADRI LIGJOR

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" është strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, e cila realizon funksione diagnostikuese e trajtuese në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor terciar, si dhe funksione mësimore e kërkimore-shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, e cila organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

QSU "Nënë Tereza" ushtron veprimtarinë e saj, sipas Ligjit Nr.10107, datë 30.03.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Ligjit Nr. 80/2015 "Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republikën e Shqiperise", të ndryshuar, Ligjit Nr. 55/2022, "Per shërbimin spitalor në Republikën e Shqiperise", Ligjin Nr. 123/2014 "Për urdhërin e mjekëve të Shqipërisë", Ligjin Nr. 9718, datë 19.04.2007, "Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 9150, datë 30.10.2003, "Për urdhrin e farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 10383, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH", VKM Nr. 66, datë 03.02.2017, "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare", VKM Nr. 654, datë 10.11.2017, "Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Qendrës Spitalore Universitare, "NËNË TEREZA".

1.3 MISIONI

- Të ofrojë shërbimin mjekësor me përkushtim, profesionalizëm dhe cilësi të lartë, duke vënë në dispozicion të të sëmurëve maksimumin e kapaciteteve njerëzore, dijeve dhe faciliteteve që disponon;
- Të japë ndihmë mjekësore të specializuar (terciare) për gjithë banorët e vendit dhe shërbim mjekësor dytësor për banorët e Tiranës, duke shërbyer me profesionalizëm sipas rregullave të deontologjisë dhe të etikës mjekësore si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe informacionin e pacientëve;
- Të trajtojë dhe t'u shërbejë të sëmurëve, sipas gjendjes dhe nevojave psikologjike dhe fizike, me standartin më të lartë deontologjik, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e të sëmurëve si dhe duke ruajtur sekretin profesional dhe privatësinë e pacientëve;
- Të shërbejë si bazë pedagogjike për formimin e studentëve të Mjekësisë, formimin e vazhdueshëm të mjekëve dhe specialistëve.

- Të shërbejë si bazë kërkimore–shkencore në fushën e shëndetësisë, në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë Tiranës dhe struktura të tjera kërkimore shkencore.

1.4 VIZIONI

- Vizioni i QSU "Nene Tereza" është që nëpërmjet administrimit efektiv dhe eficient të burimeve, shfrytëzimit të mekanizmave të përmirësuar të financimit, zhvillimit të standardeve, rritjes së kapaciteteve e kompetencave, futjes së teknikave e praktikave të reja dignostikuese e mjekuese, të realizojë trajtim mjekësor cilësor dhe konkurrues, të rrisë përkujdesin ndaj të sëmurëve dhe trajtimin me sukses të sëmundjeve të tyre, si dhe të konsolidojë statusin e një qendre prioritare kompetence dhe ekselence në fushën e shkencave mjekësore.

1.5 VLERAT DHE PARIMET

Vlerat dhe parimet themelore të funksionimit të QSUT përfshijnë shërbimin, partneritetin, kujdesin dhe integritetin. Ne punojmë fort që të sigurojmë kujdes maksimal dhe të trajtojmë të gjithë pacientët më të njejtën siguri, dinjitet dhe respekt.

Vlerat tona që na mundësojnë të arrijmë misionin dhe vizionin tonë:

- Empatia: Ne kujdesemi për të lehtësuar vuajtjet dhe për të krijuar gëzim sa herë që është e mundur.
- Puna ekipore: Ne punojmë së bashku për të siguruar kujdesin, sigurinë dhe mirëqenien më të mirë të mundshme të pacientëve dhe kolegëve tanë.
- Përfshirja: Ne krijojmë qëllimisht një mjedis ku të gjithë vlerësohen dhe respektohen.
- Integriteti: Ne i përmbahemi parimeve të larta morale dhe standardeve profesionale duke u përkushtuar ndaj ndershmerisë, konfidencialitetit, besimit, respektit dhe transparencës.
- Cilësi dhe siguri: Ne sigurojmë standardet më të larta dhe rezultate të shkëlqyera përmes ndërveprimeve efektive, vendimmarrjes dhe veprimeve.
- Inovacioni: Ne drejtojmë ndryshime të vogla dhe të mëdha për të transformuar kujdesin shëndetësor kudo.

1.6 QSU "NËNË TEREZA" NË SHIFRA

1.6.1 AKTIVITETI SPITALOR

Treguesit e aktivitetit spitalor të QSUT, janë analizuar shërbimet me shtretër dhe shërbimet ditore të dedikuara ndaj pacientëve.

Në total, në vitin 2022:

- Numri i pacientëve të shtruar në spital është rritur me 4.6%, krahasuar me vitin 2021 (tab.1).
- Ditëqëndrimi mesatar është ulur lehtësisht, krahasuar me vitin 2021.
- Xhiro e shtratis është rritur me 33%, krahasuar me vitin 2021; ndërsa
- Ditëshfrytëzimi i shtratis është rritur me rreth 16%, krahasuar me vitin 2021.

Tab. Të dhëna të përgjithshme të aktivitetit spitalor ne 5 vitet e fundit

PACIENTË	NUMRI (2018)	NUMRI (2019)	NUMRI (2020)	NUMRI (2021)	NUMRI (2022)
Të shtruar	102568	112698	86178	109481	114558
Vizita në Urgjencë	317111	323360	154443	207639	222332
Ambulatorë (nr personash/raste total)	223460	235528	140532	181884	200765

PACIENTË	NUMRI (2018)	NUMRI (2019)	NUMRI (2020)	NUMRI (2021)	NUMRI (2022)
Ambulatorë(Numri i pacienteve TOTAL)	420607	428992	232450	324295	358468

Aktiviteti spitalor

Tab. Treguesit kryesorë të aktivitetit të QSUT në vite

VITI	NR I SHTRËTËR VE	NUMRI I PACIENTË VE TË DALË	DITËQËNDRIMI TOTAL	DITËSHFYTËZIMI SHTRATIT (%)	DITËQËNDRIMI MESATAR	XHIRO E SHTRATIT
V 2018	1,391	102,673	482,803	95.09	4.7	73.81
V 2019	1,391	112,855	484,384	95.4	4.29	81.13
V 2020	1,669	88,112	322,504	52.9	3.66	52.79
V 2021	1,769	109,579	434,015	67.22	3.96	61.9
V 2022	1391	114668	422352	83.19	3.68	82.44

Spitali ditor

Në vitin 2022, rregjistrohet një rritje me 13.7% e numrit total të rasteve, që trajtohen në spitalet ditore, krahasuar me vitin 2021.

- Në total, në vitin 2022, janë kryer 5144 angiografi dhe angioplastikë koronare, të cilat janë shtuar me 6% krahasuar me 4853 angiografi dhe angioplastikë koronare, të kryera në vitin 2021. Në vitin 2021, janë rritur me rreth 13% (12.66%) by-passet aorto-koronare, krahasuar me vitin 2021.
- Paketat Adjuvante / Neoadjuvante janë dyfishuar në vitin 2022, krahasuar me një vit më parë.

1.6.2 NDËRHRYJET KIRURGJIKALE


Tab. Numri i operacioneve në vite, në QSUT

NR I OPERACIONEVE	TOTALI	# NË % ME NJË VIT MË PARË
Viti 2018	28087	4.6
Viti 2019	25871	-7.9
Viti 2020	13514	-47.8
Viti 2021	20409	51.2
Viti 2022	22763	11.53

Në vitin 2022 rregjistrohet rritje e numrit total të operacioneve, me 11.5%, krahasuar me vitin 2020.

Vihet re rritje e numrit të operacioneve të kryera në QSUT në vitin 2022 (2354 operacione më shumë), krahasuar me numrin e operacioneve të kryera në vitin 2021.

Graf. Trendi i operacioneve sipas muajve ne QSUT, për vitet 2018-2022



Tab. Numri i operacioneve sipas shërbimeve të QSUT

SHËRBIMET	NR I OPERACIONE VE 2018	NR I OPERACIONEVE 2019	NR I OPERACIONEVE 2020	NR I OPERACIONEVE 2021	NR I OPERACIONEVE 2022	# VITET 2022-2021 (NR)	# VITET 2022-2021 (%)
Okulistikë	6544	4795	2444	4081	5221	1140	27.93
ORL	1382	1443	682	887	974	87	9.81
OMF	588	567	266	416	496	80	19.23
Onkologji	1850	1582	982	1205	1176	-29	-2.41
Kirurgji e Përgjithshme	1572	1466	895	1488	1882	394	26.48
Kirurgji e traktit Gastro-Intestinal	2113	2150	1202	1921	2477	556	28.94
Kirurgji urologjike	1663	2016	1450	2209	2523	314	14.21
Kirurgji plastike	1712	1885	883	1491	1896	405	27.16
Kirurgji pediatrike	4465	3475	1870	2546	2662	116	4.56
Kirurgji vazale	989	1188	578	738	1026	288	39.02
Kardiokirurgji	863	882	729	812	876	64	7.88
Neurokirurgji	1203	1241	1097	1279	1303	24	1.88
Urgjenca Kirurgjikale	3143	3181	436	1336	251	-1085	-81.21
Totali	28087	25871	13514	20409	22763	2354	11.53

1.6.3 BURIMET NJERËZORE

Burimet Njerëzore janë themeli i suksesit në Institucionin tonë. Fryma e punës në QSUT është një frymë perëndimore me në qëndër pacientin. Stafi ynë duke punuar në një institucion kaq dinamik është një staf gjithmonë në rritje. Punësimi i të rinjve është një nga politikat e spitalit, përtë ndërthur energjinë e motivimin për profesionin e punonjësve të rinj me pagabueshmërinë e eksperiencës.

- Aktualisht në Qendrën Spitalore Universitare ushtrojnë aktivitetin e tyre një numër total të punësuarish prej 2897, nga të cilët 2607 janë staf mjekësor, 290 staf administrativ. Në spital punojnë 311 mjekë, 136 mjekë pedagogë, dhe 1137 staf infermieror.
- Të punosh në QSUT do të thotë së pari të përmbushësh një mision, një përpjekje të pakursyer për të bërë një ndryshim domethënës në jetën e dikujt duke shërbyer me profesionalizëm, mirësi dhe shumë përkushtim.
- QSUT i shërben këtij misioni duke ofruar mundësinë e përmirësimit dhe rritjes së aftësive të punonjësve të saj, mundësi të shumta të zhvillimit të karrierës dhe edukimit të vazhdueshëm profesional.
- Është e rëndësishme që stafi ynë të jetë i motivuar për të arritur ato qëllime të cilat do të ndihmonin progresin e tyre individual dhe përmirësimin e shërbimit të spitalit.
- Është e rëndësishme për ne të nxisim dhe mbajmë gjallë dëshirën e fortë për arritje, frymën e punës në grup, të menduarit në mënyrë të pjekur dhe të sjellurit në respekt të etikës profesionale.
- Është e rëndësishme për ne të nxisim dhe mbajmë gjallë dinamizmin, përgjegjshmërinë, mirësjelljen dhe integritetin.
- Është e rëndësishme për ne të ndjehet se duke i shërbyer misionit tonë të madh, jemi në të njëjtën kohë, duke ndihmuar dhe shpërblyer veten.

"Mund të kesh strategjinë dhe ndërtesën më të mirë në botë, por nëse nuk ke zemrat dhe mendjet e njerëzve të cilët punojnë me ty, asnjëra nuk merr jetë."


– Renee West



1.7 BUXHETI

Burimet e financimit të QSU "Nënë Tereza", përbëhen nga:

- Buxheti i shtetit;
- financimet;
- donacionet;
- të ardhurat e krijuara nga institucioni.



Gjatë katër viteve të fundit, buxheti i QSUT është rritur afërsisht 19.37%.

QSU "Nënë Tereza" financohet nga buxheti i shtetit dhe Fondi i Detyrueshëm i Sigurimeve Shëndetësore FSDKSH, sipas kontratës së financimit të nënshkruar midis dy palëve, e cila është e vlefshme për një periudhë një vjecare.

Mënyra dhe forma e financimit të spitalit përcaktohet në kontratën e lidhur midis QSU "Nënë Tereza" dhe FSDKSH.

QSU "Nënë Tereza", siguron të ardhura (dytësore) nga çdo shërbim mjekësor të dhënë sipas tarifave të miratuara nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë.

Të ardhurat e siguruar janë pjesë e buxhetit të spitalit. Këto të ardhura përdoren sipas legjislacionit në fuqi.

QSU "Nënë Tereza" mund të kërkojë dhe pranojë mbështetje financiare edhe nga donatorë të ndryshëm, vendas apo të huaj.


1.8 PROJEKSIONI I POPULLSISË SË CILËS I OFROHET KUJDES

Në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza marrin kujdes shëndetësor qytetarët e Tiranës dhe të gjithë rastet e referuara nga spitalet rajonale dhe bashkiake, për kujdes më të specializuar.


Nga të dhënat zyrtare të INSTAT, Tirana zë rreth 33,5 % të popullsisë gjithsej, duke vazhduar të jetë një nga qarqet më të populluara të vendit, ndjekur nga Durrësi dhe Fieri me nga 10,5 % dhe 9,8 % përkatësisht.

Sa i përket qarqeve të tjerë, pesë prej tyre zënë respektivisht nga 1,9 % deri 4,1 % të popullsisë gjithsej.

Përlllogaritjet e popullsisë më 1 janar 2023 tregojnë se vetëm një qark i vendit shënojnë rritje të popullsisë, krahasuar me një vit më parë, ndërsa njëmbëdhjetë qarqet e tjerë shënuan rënie të popullsisë. Rritja u shënuar në Tiranë (+ 0,6 %).



Pjesa që zë popullsia e secilit qark në popullsinë gjithsej më 1 janar2023



Norma vjetore e ndryshimit të popullsisë sipas qarkut, 1 janar2023 vs 1 janar2022

Projeksionet e popullsisë sipas skenarit të rajonalizuar (qarqet), skenari i rritjes së mesme, 2021, 2026, 2031

VITI	POPULLSIA TOTALE
2021	891 526
2026	926 292
2031	954 280

Ndryshimet demografike që pritet të kalojë popullsia e Shqipërisë deri në vitin 2031 do të kenë ndikimin e tyre edhe në shpërndarjen e saj ndërmjet qarqeve të vendit. Deri në vitin 2031, vetëm popullsia e qarkut të Tiranës pritet të jetë më e lartë se ajo e vitit 2019, duke arritur në rreth 954 mijë banorë. Në vitin 2031, në qarkun e Tiranës pritet të banojë rreth 35% e popullsisë së Shqipërisë.

Për rëndësinë e madhe që ka QSUT në sektorin publik shëndetësor si dhe referuar projeksioneve të INSTAT, plani strategjik do të hartohet duke marrë në konsideratë ndryshimet demografike të popullsisë.

2 STRATEGJIA

2.1 QELLIMI I STRATEGJISË

Ky plan strategjik është një dokument që është hartuar bazuar në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, rekomandimet e lëna nga ekspertët e kontraktuar nga Conseil Sante gjatë projektit që u zhvillua për strategjinë e re të menaxhimit të QSUT, nevojat e popullatës që i ofron kujdes, si dhe në bashkëpunim me shërbimet mjekësore dhe strukturat mbështetëse administrative.

Stafi shëndetësor dhe mbështetës është i angazhuar për zbatimin e suksesshëm të këtij plani për të siguruar kujdes shëndetësor cilësor në mënyrën më efektive të mundshme.

Ky plan do të mbështesë dhe inkurajojë inovacionin në përmirësimin e rezultateve, përvojën e pacientit dhe efikasitetin në ofrimin e kujdesit dhe shërbimeve. Qëllimi ynë është që të demonstrojmë performancë të lartë duke realizuar praktika të reja që adresojnë nevojat shëndetësore të pacientëve.

QSUT do t'i japë përparësi objektivave që kanë potencialin më të madh për ndikim në përmirësim, për të optimizuar funksionet klinike në mënyrë që të arrijmë qëndrueshmëri në proces dhe parashikueshmëri në rezultate.

QSUT synon të përmirësojë sigurinë e pacientit, të rrisë efikasitetin duke krijuar mjedisin e përshtatshëm të shërimin dhe t'i sigurojë personelin mjedisin e dëshiruar të punës.

QSUT i shërben mijëra qytetarëve dhe duhet dizenuar në përputhje me pritshmëritë e tyre.

Duke punuar së bashku, ne kërkojmë koncepte të reja dhe alternative duke i dhënë formë funksionalitetit të dëshiruar të një spitali modern.

2.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Një analizë e kontekstit social, politik, ekonomik dhe mjedisor ka ndihmuar në identifikimin e objektivave strategjike që do të adresohen gjatë tre viteve të ardhshme.

Këto synime strategjike dhe objektiva specifike do të udhëheqin procesin e planifikimit operacional, duke përfshirë zhvillimin e planeve vjetore.

Ky plan strategjik është premtimi i një spitali universitar inovativ, më i hapur ndaj komunitetit të tij, i cili ndërtohet në një frymë të fortë bashkëpunimi, i jep përparësi pacientëve dhe stafit për t'i integruar më mirë në kujdesin, shërbimet dhe aktivitetin e qendrës spitalore.

Objektivat strategjike të jenë si më poshtë vijon:

- Modernizimi i infrastrukturës spitalore
- Përmirësimi i sistemit informatik spitalor
- Implementimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, bazuar në standartet ISO 9001:2015
- Fuqizimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit
- Krijimi i një platforme interaktive për pacientë "Pacientët si partnerë"

2.2.1 MODERNIZIMI I INFRASTRUKTURËS SPITALORE

Me vizionin për modernizimin e qendrës më të madhe spitalore në vend, 5 vite më parë nisi zbatimin e masterplanit për QSUT. Pas përfundimit të veprave si Spitali Kirurgjikal "Frederik Shiroka", Spitalit të ri Pediatric, Spitalit Infektiv, Depos Farmaceutike QSUT, Spitalit Qendror vijon puna me intensitet për fazën e dytë të rindërtimit të Spitalit Pediatric, e në vijim do të hapen investime të reja me projektet për rehabilitimin e Spitalit të Kardiokirurgjisë, Spitalit Psikiatrik dhe atij të Djegje-Plastikës në QSUT.



SPITALI QENDROR, vepra më e madhe e shëndetësisë në tre dekadat e fundit, ka një sipërfaqje ndërtimi 23,290 m², me kapacitet 345 shtretër ku akomodohen 14 shërbime mjekësore spitalore të specializuara nga kardiologjia, nefrologjia, hematologjia, gastrohepatologjia, mjekësia interne, endokrinologjia, dermatologjia, reumatologjia, alergologjia, urgjenca dhe imazheria.

Pas funksionalizimit të Spitalit Qendror, ka vijuar zbatimi i masterplanit me fazën e dytë që është ndërtimi i Spitalit Ditor, ku do të akomodohen shërbimi i Hematologjisë, Hemodializës, dhe Toksikologjisë.

Gjithashtu pas përmbylljes së fazës së parë të investimit në Spitalin Pediatrik të QSUT, po vijon faza e rehabilitimit të plotë të Pediatriisë së Përgjithshme. Projekti me një kapacitet prej 120 shtretërish, përfshin zgjerimin e shërbimit të onko-hematologjisë, dializës, pneumologjisë etj. Me përfundimin e fazës së dytë kompletohet i gjithë korpusi i Spitalit Pediatrik në QSUT.

Modernizimi i infrastrukturës po ecën paralelisht me fuqizimi e flotës së pajisjeve mjekësore.





Investimet e reja në infrastrukturë dhe pajisje mjekësore do të sjellin:

- Sigurimin e trajtimit të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë për pacientin;
- Alokimin efikas i resurseve;
- Do të përmirësohet cilësia e shërbimeve mjekësore
- Do të optimizohen proceset;
- Do të krijohen shërbime të centralizuara;
- Do të rritet efikasiteti nëpërmjet optimizimit të shfrytëzimit të burimeve, mirëshpërndarjes së tyre dhe shfrytëzimit efikas të pajisjeve mjekësore;
- Reduktimi i kostove të energjisë dhe mirëmbajtjes;

HISTORIA JONË DJE DHE SOT



2.2.2 PËRMIRËSIMI I SISTEMIT INFORMATIK SPITALOR

Zhvillimi i një spitali inovativ dixhital efikas dhe efektiv kërkon patjetër përmirësimin e sistemit informatik spitalor.

Për të ofruar një trajtim cilësor eficient të orientuar nga pacienti, QSUT fokusohet në tre faktorë: një mjedis me qendër dixhitale, përmirësimin e përvojës së pacientit dhe ofrimin e trajtimit bashkëpunues. Një mjedis me qendër dixhitale, si mundëson trajtime që janë të integruara me menaxhimin e të dhënave dhe krijon një platformë dixhitale përmes së cilës duhet të përmirësohet efikasiteti i menaxhimit dhe ndërveprueshmëria. Krijimi i një fluksi të tillë pune optimale të bazuar në të dhëna promovon efikasitetin e punës duke reduktuar detyrat e përsëritura. Përmirësimi i përvojës së pacientit rrit stabilitetin dhe besimin ndaj personelit shëndetësor duke ofruar informacion gjithëpërfshirës, të orientuar nga pacienti nga testimi/trajtimi deri në daljen e tij nga spitali.

Gjithashtu, ofrimi i trajtimit bashkëpunues promovon aftësinë e personelit mjekësor, drejtuesve dhe punonjësve dhe përforcon fuqinë vendimmarrëse klinike nëpërmjet zgjidhjeve dixhitale. Për më tepër, ofron shërbime të personalizuar dhe të integruara për pacientët nën trajtim bashkëpunues.

Spitalet dixhitale synojnë të ndërtojnë zgjidhje inteligjente dhe inovative që lejojnë personelin mjekësor të fokusohet plotësisht në trajtimin e pacientit duke reduktuar ngarkesën e panevojshme të punës dhe duke maksimizuar sigurinë e pacientit.

Faktorët kryesorë për një spital inovativ dixhital janë siguria dhe komoditeti i pacientit me cilësi të lartë. Për t'i arritur këto, QSUT paraqet zgjidhje të ndryshme dixhitale që shkojnë përtej adoptimit të thjeshtë të pajisjeve ose sistemeve të reja.

Si rezultat, janë zhvilluar zgjidhje të ndryshme dixhitale, duke përfshirë aplikacionet celulare për pacientët dhe një aplikacion mesazhesh për trajtimin bashkëpunues të mjekëve.

Aplikacion celular për pacientët

Një aplikacion celular për pacientët që ofron shërbime dixhitale. Me fillimin e praktikës së dyfishtë në spitalet që do të përftojnë autonominë menaxheriale dhe më pas atë financiare, pacientët mund të lënë takimin e tyre jashtë sistemit të referimit duke kontrolluar informacionin në lidhje me departamentin mjekësor dhe mjekun specialist në aplikacionin celular. Pacientët gjithashtu mund të kryejnë pagesën online për të gjithë shërbimet të cilat duan të marrin në QSUT.



Aplikacion për bashkëpunimin e personelit mjekësor

Për të promovuar efikasitetin e bashkëpunimit midis stafit mjekësor përmes komunikimit më të shpejtë nevojitet një aplikacion celular i cili do të përdoret nga stafi në mënyrë aktive.

Duke përdorur aplikacionin bashkëpunues të mjekësisë spitalore, një mesazher në kohë reale për të diskutuar gjendjen e pacientit, reduktohet koha e pritjes për trajtime dhe diagnoza multidisciplinare.



Monitor dixhital informues në dhomat e pacientëve

Monitorët dixhital në dhomat e pacientëve kanë një rol informues dhe rrisin kënaqësinë e pacientit gjatë qëndrimit në spital. Zgjidhje të tilla janë përparime dixhitale të dizajnuara për të kthyer çdo zonë të vizituar nga pacienti në mjedisin mjekësor më optimal.

Nëpërmjet posterave dixhital ofrohet një përvojë inovative për pacientit. Pacientët njihen me rreguloret e spitalit, udhëzime të ndryshme për qëndrimin në spital, edukimin terapeutik në lidhje me diagnozën e tij etj. të ilustruara me video.



Në vijim të përmirësimit të sistemit informatik ekzistues, konsulentët e Conseil Sante, të cilët punuan për strategjinë e re të menaxhimit të QSUT rekomanduan që të zhvillohen modulet si më poshtë:

- Planifikimi i stafit - një modul regjistri për shërbimet e planifikuara të personelit mjekësor dhe infermieror.
- Kapaciteti i personelit infermieror – një modul për të regjistruar ngarkesën e stafit gjatë kujdesjeve infermiere.
- Dokumentacioni infermieror - një modul për planifikimin dhe dokumentimi e kujdesjeve infermiere për të standardizuar dokumentacionin e përgjithshëm.

- Planifikimi i bllokut operator - një modul për të planifikuar operacionet dhe për të regjistruar ngjarjet gjatë ndërhyrjes operative.
- Integrimi i sistemit të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë – një modul gjithëpërfshirës për të përfutur të dhëna të matshme që lidhen me indikatorët e performancës.

Dixhitalizimi i Udhërrëfyesve dhe protokolleve të praktikës klinike dhe procedurat e kujdesit infermior.

Udhërrëfyesit dhe protokollet e praktikës klinike janë thelbësore për sigurimin e cilësisë së shërbimit. Ata sigurojnë që proceset të kryhen në mënyrë të standardizuar dhe janë instrument për përmirësimin e kujdesit mjekësor të ofruar.

Udhërrëfyesit e praktikës klinike dhe protokollet mjekësore janë të gjitha dokumente udhëzuese për përcaktimin e karakteristikave të pacientit, rrjedhave dhe aspekteve të ndryshme të shëndetit publik dhe menaxhimit të rasteve.

Gjatë projektit për strategjinë e re të menaxhimit të QSUT, protokollet u përkthyen në anglisht dhe u konvertuan në material elektronik. Konsulentët propozuan konfigurimin e tyre në sistemin informatik për të shërbyer si një bibliotekë dixhitale për stafin mjekësor.

Gjithashtu procedurat e kujdesjeve infermiore janë gjerësisht në përdorim në QSUT, por duhet të zhvillohen sipas referencave ndërkombëtare nga grupet e brendshme të punës së infermierëve. Puna e vazhdueshme për përditësimin dhe plotësimin duhet të ndërmerret nga vetë QSUT, nën drejtimin e ekipit të performancës dhe me grupe pune sipas specialitetit. Edhe procedurat e kujdesjeve infermiore do të dixhitalizohen për të shërbyer si orientim, kryesisht për personelin e ri infermior.

2.2.3 IMPLEMENTIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË, BAZUAR NË STANDARTET ISO 9001:2015



Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e sigurisë së pacientit nëpërmjet zbatimit të një sistemi të menaxhimit të cilësisë është mënyra më e mirë për të ofruar kujdes me në qendër pacientin.

ISO 9001:2015 ofron një model për një sistem të menaxhimit të cilësisë i cili fokusohet në efektivitetin e proceseve klinike dhe mbështetëse për të siguruar ofrimin e kujdesit me cilësi të lartë. Standardi promovon adoptimin e një qasjeje që thekson efektivitetin e procesit dhe përmirësimin e vazhdueshëm nëpërmjet matjeve objektive.

Për të implementuar një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë, stafi duhet të duhet të njihet me kërkesat e standardit ISO 9001:2015 nëpërmjet programeve të trajnimit të cilat do të bazohen në referencat më të mira ndërkombëtare.

Zhvillimi i një plani për përmirësimin e proceseve është një masë e nevojshme për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit tonë. Qëllimi është të përmirësohen aktivitetet ekzistuese për të maksimalizuar kënaqësinë e pacientëve ndaj shërbimit të ofruar, të optimizojnë faturimin, të planifikojnë rrugët klinike sa më saktë që të jetë e mundur dhe të përcaktojnë qartë rolet e profesionistëve të përfshirë gjatë qëndrimit të pacientit.

2.2.4 FUQIZIMI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Aktivitetet kërkimore janë pjesë integrale e misionit të QSUT dhe do të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me Universitetin e Mjekësisë.

Fokusi ynë është të promovojmë kërkimin klinik brenda QSUT dhe Fakultetit të Mjekësisë duke zhvilluar kërkime në përputhje me prioritetet e përcaktuara nga të dy institucionet.

Të bindur se "të gjithë mund të bëjnë ndryshimin", QSUT planifikon të ndërtoj një Qendër Inovacioni , për të promovuar dhe materializuar idetë më të mira të punonjësve, me synimin për të përmirësuar dhe zhvilluar qendrën spitalore.

Qendra e Inovacionit i mundëson çdo personi, me aftësitë e tij profesionale dhe personale, në zhvillimin e përbashkët të zgjidhjeve inovative që do të avancojnë spitalin.

Si një qendër aftësish ashtu edhe një hapësirë pune bashkëpunuese, Qendra e Inovacionit do të ofroj një sërë mundësish për të promovuar idetë dhe katalizuar projekte.



2.2.5 KRIJIMI I NJË PLATFORME INTERAKTIVE PËR PACIENTË "PACIENTËT SI PARTNERË"

Si institucion publike, QSUT merr përsipër të ofroj shërbime me cilësi të lartë për të gjithë popullatën, pavarësisht nga statusi socio-ekonomik. Për të marrë parasysh nevojat në ndryshim, QSUT synon të gjejë një mënyrë konstruktive për të përfshirë pacientët dhe të afërmit e tyre në diskutimet që synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Si përfitues të shërbimeve, pacientët janë të vendosur në mënyrë perfekte për të vlerësuar cilësinë e tyre dhe sugjerimet e tyre janë një mënyrë vendimtare për të identifikuar fushat për përmirësim.

Për të përfshirë pacientët dhe të afërmit e tyre në të menduarit strategjik për të ardhmen e QSUT, do të krijohet një platformë "Pacientët si Partnerë" për të organizuar diskutime, për të inkurajuar dialogun dhe për të siguruar që ndërveprimet të jenë të dukshme dhe produktive.

Fillimisht do të fokusohet në organizimin e takimeve të rregullta dhe përcaktimin e një sërë temash për shqyrtim. Më pas, pacientët do të ftohen të marrin pjesë në diskutime. Temat e trajtuara do të mbulojnë aspektet logjistike dhe teknike, si dhe çështjet mjekësore dhe infermierore.

Në të ardhmen, platforma duhet të jetë në gjendje të zgjerojë gamën e aktiviteteve të saj, duke ofruar një zonë të dedikuar në faqen zyrtare elektronike të spitalit. Platforma "Pacientët si Partnerë" do të ndihmojë në vlerësimin dhe optimizimin e procesit të kujdesit, duke marrë parasysh sugjerimet e pacientëve.





"Jo të gjithë mund të bëjnë gjëra të mëdha. Por ne mund të bijmë gjëra të vogla me dashuri të madhe!"



QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE
"NËNË TEREZA"